

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara

SKK 10 GRANTET DHE FORMA TË TJERA TË NDIHMËS

Pg		Paragrafët
	STANDARDI KOMBËTAR I KONTABILITETIT NR. 10 – GRANTET DHE FORMA TË TJERA TË NDIHMËS – I PËRMIRËSUAR	
	PËRMBAJTJA	
	OBJEKTIVI DHE BAZA E PËRGATITJES	1-3
	FUSHA E ZBATIMIT	4-6
	PËRKUFIZIMET KRYESORE	7-8
	GRANTET Njohja dhe matja e granteve	9-11 9-11
	PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E PERFORMANCËS	12-13
	SHËNIMET SHPJEGUESE	14
	DISPOZITA KALIMTARE	15
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	16
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (SNRF PËR NVM)	17
	BAZA E KONKLUZIONEVE	
	UDHËZUES PËR ZBATIMIN E SKK 10	
	OBJEKTIVI DHE BAZA E PËRGATITJES	
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 10, <i>Grantet dhe forma të tjera të ndihmës</i> ('SKK 10' ose 'Standardi'), i nxjerrë dhe i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe i shpallur nga Ministria e Financave, i ndryshuar, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëposhtëm të granteve dhe formave të tjera të ndihmës në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Këto standarde bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 9 228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar.	
2	SKK 10 mbështetet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit, SNK 20 <i>Kontabiliteti i granteve qeveritare dhe dhënia e informacioneve shpjeguese për ndihmën qeveritare</i> . SKK 10 është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 24 – <i>Grantet qeveritare</i> të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Njësiti Ekonomike të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit Kombëtar me paragrafë të SNRF për NVM është dhënë në paragrafin 17. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 10 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare, dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare të kapitalit të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin 9 të Ligjit nr. 9 228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", publikuar në prill 2004, i ndryshuar.	
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat domaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 40 deri në 90 të SKK 1.	
	FUSHA E ZBATIMIT	
4	Ky standard do të përdoret për trajtimin kontabël dhe shpjegimin e granteve dhe formave të tjera të ndihmës.	
5	Ky standard do të përdoret për përgatitjen e pasqyrave financiare nga ato njësi ekonomike, të cilat kanë marrë grante ose forma të tjera ndihme. Parimet dhe kërkesat e paraqitura në këtë standard do të përdoren në lidhje me grantet e marra nga organizma qeveritare dhe joqeveritare, për sa kohë që këto organizma nuk janë aksionarë të njësisë ekonomike, si dhe kërkesat e SKK 10 nuk bien ndesh me SKK të tjera, që trajtojnë këto aspekte dhe sigurojnë një paraqitje të vërtetë e të besueshme.	
6	Ky standard nuk trajton aspektet e mëposhtme:	

	<p>(a) trajtimi kontabël dhe shënimet shpjeguese të ndihmës në pasqyrat financiare të organizatave dhe shoqërive që japin ndihmë;</p> <p>(b) ndihmën qeveritare që i jepet një njësie ekonomike në formën e lehtësirave në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme ose në formën e detyrimit të kufizuar tatimor. Shembuj të përfitimeve të tilla janë aktivitetet e përjashtuara nga tatimet, e drejta për kreditimin e tatimit mbi investimet e bëra, zbritja e amortizimit të përshpejtuar dhe norma të reduktuara të përqindjes së tatimit mbi fitimin (SKK 11 <i>Tatimi mbi fitimin</i>).</p>
	PËRKUFIZIMET KRYESORE
7	<p>Më poshtë jepen disa përkufizime të termave kryesorë të përdorura në këtë standard:</p> <p><u>Ndihma</u> është një veprim i ndërmarrë nga një organizëm qeveritar ose joqeveritar, me synimin për t'i ofruar një përfitim ekonomik të veçantë një njësie ekonomike apo një tërësie njësisë ekonomike që plotësojnë disa kritere të përcaktuara. Shembujt përfshijnë këshillimin teknik ose të marketingut falas, sigurimin e garancive dhe huave me normë interesi zero ose të ulët. Ndihmës nuk mund t'i caktohet një vlerë e arsyeshme.</p> <p>Ndihma e trajtuar në këtë standard nuk ka të bëjë me lehtësirat që ofrohen në mënyrë të tërthortë e që ndikojnë mbi tregëtinë në përgjithësi, si për shembull ofrimi i infrastrukturës në zona që kanë nevojë për zhvillim, vendosja e kufizimeve tregtare mbi konkurrentët, apo sigurimi i kushteve lehtësuese, si vaditjet ose rrjetëzimet e ujit, çka i ofrohet në mënyrë të vazhdueshme dhe pa dallim një komuniteti të tërë.</p> <p><u>Grantet</u> janë ndihmë e dhënë nga një organizëm qeveritar ose joqeveritar, në formën e transferimit të burimeve apo aktiveve të një njësie ekonomike, përkundrajt plotësimit në të shkuarën ose në të ardhmen të disa kushteve të paracaktuara që lidhen me aktivitetet e shfrytëzimit të kësaj njësie ekonomike. Këtu bëjnë përjashtim transaksionet me qeverinë, të cilat nuk mund të dallohen nga veprimet normale tregtare të njësisë ekonomike (për shembull, një prokurim nga ana e organeve qeveritare, nëpërmjet së cilës realizohet një pjesë e shitjeve të njësisë ekonomike).</p> <p><u>Borxhet e falshme</u> janë borxhe, për të cilat huadhënësi merr përsipër të anulojë ripagesën e tyre, në varësi të plotësimit të disa kushteve të caktuara.</p>
8	Grantet ndryshojnë nga format e tjera të ndihmës pasi vlera e tyre monetare mund të përcaktohet relativisht me saktësi dhe mund të dallohet nga transaksionet e tjera të zakonshme tregtare të njësisë ekonomike.
	GRANTET Njohja dhe matja e granteve
9	<p>Një njësi ekonomike i njeh grantet si vijon:</p> <p>(a) Një grant që nuk imponon kushte të specifikuar të performancës në të ardhmen mbi përfituesin njihet në të ardhura, kur granti është arkëtuar.</p> <p>(b) Një grant që imponon kushte të specifikuar të performancës në të ardhmen mbi përfituesin njihet në të ardhura vetëm kur kushtet e performancës janë plotësuar.</p> <p>(c) Grantet e marra para se të plotësohet kriteri i njohjes së të ardhurave njihen si një detyrim.</p>
10	Një njësi ekonomike do të masë grantet e përfuara me vlerën e drejtë të aktivitetit të marrë ose për t'u marrë.
11	Një borxh i falshëm trajtohet si një grant kur ka siguri të mjaftueshme që njësi ekonomike do të plotësojë kushtet e paracaktuara për faljen e borxhit.
	PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E PERFORMANCËS
12	Aktivitetet e marra ose të blera nëpërmjet granteve njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në të njëjtën mënyrë siç njihen aktivitetet e tjera të të njëjtit lloj.
13	Të ardhurat dhe shpenzimet, që lidhen me grantet, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në zërat "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit/dhe shpenzime të tjera të shfrytëzimit" ose si zë më vete.
	SHËNIMET SHPJEGUESE
14	<p>Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm, në lidhje me grantet dhe ndihma të tjera:</p> <p>(a) natyrën dhe shumën e granteve të njohura në pasqyrat financiare;</p> <p>(b) kushtet e papërbushura dhe detyrimet e kushtëzuara të lidhura me grantet që nuk kanë qenë të njohura në të ardhurat;</p> <p>(c) një përshkrim të formave të tjera të ndihmës qeveritare ose joqeveritare nga të cilat njësi ekonomike ka përfituar drejtpërdrejt.</p>
	DISPOZITA KALIMTARE
15	Në vitin e parë të zbatimit të këtij standardi të përmirësuar, njësi ekonomike inkurajohet por nuk kërkohet të zbatojë në mënyrë retrospektivë këtë standard. Nëse nuk mund të bëhet zbatimi në retrospektivë pa kosto shtesë do të jepen informacione tek shënimet shpjeguese lidhur me trajtimin kontabël të granteve kapitale në të shkuarën duke shpjeguar edhe vlerat e mbetura të të ardhurave të shtyra në pasqyrën paraardhëse.

	DATA E HYRJES NË ZBATIM	
16	Ky standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive.	
	KRAHASIMI ME STANDARDIN NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (SNRF PER NVM).	
17	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij standardi me SNRF për NVM. Paragrafët janë trajtuar si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti që përshkrimet në standardin e referuar mund të kenë ndryshime.	
	Paragrafët sipas SKK 10	Paragrafët sipas SNRF për NVM botuar në korrik 2009
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 24.1
	Paragrafi 5	Asnjë
	Paragrafi 6	Sek. 24.3
	Paragrafi 7	Sek. 24.1, 24.2, 24.7
	Paragrafi 8	Asnjë
	Paragrafi 9	Sek 24.4
	Paragrafi 10	Sek. 24.5
	Paragrafi 11	Asnjë
	Paragrafi 12	Asnjë
	Paragrafi 13	Asnjë
	Paragrafi 14	Sek 24.6
	Paragrafi 15	Asnjë
	Paragrafi 16	Asnjë